



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.20/2018
Prishtinë, më 19.3.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Mimoza Kusari – Lila dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

I ftuar: Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Ibrahim Rexhepi, Shkumbin Asllani, Lulëzim Demolli, Shahe Kukaj – Krasniqi, MZHE; Bardha Ahmeti, OJQ “LENS”; Dardan Abazi, INDEP; Fjolla Uka, KDI; Fitnete Rrahimi, “Zëri”; Vullnet Krasniqi, Klan Kosova; Liridona Xhemajli, RTV21; Amir Qamili, BIRN; Albert Krasniqi, KDI; Dren Ajeti, KPK.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.3.2018;**
3. **Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z.Valdrin Lluka, lidhur me gjendjen në:**
 - a) **Shoqërinë Aksionare Trepça SH.A.;**
 - b) **Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SH.A.; dhe,**
 - c) **Ndërmarrjen Publike Telekomit i Kosovës SH.A.;**
4. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.3.2018.

Procesverbali i mbledhjes së datës 14.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, lidhur me gjendjen në: a) Shoqërinë Aksionare Trepça SH.A.; b) Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SH.A.; dhe, c) Ndërmarrjen Publike Telekomit i Kosovës SH.A.

a) Shoqëria Aksionare Trepça SH.A.

Kryetarja– Situata e krijuar në ndërmarrjet publike, me theks të veçantë në Trepçë, është jo vetëm shqetësuese në kuptimin ekonomik e social, por edhe në atë ligjor, të funksionimit të Trepçës. Shtrohet pyetja, pse pas kaq muajsh qeverisje nga kjo Qeveri, ju si ministër nuk keni filluar me implementim të Ligjit për Trepçën? Sot, ju kemi ftuar të kuptojmë se cilat janë pengesat ligjore në moszbatim të këtij ligji, kur e dimë se ky ligj ka hyrë në fuqi më 31.10.2016 dhe nuk po e shohim asnjë hap para, në zbatim të këtij ligji. Zbatimi i këtij ligji do të nënkuptonte de fakto dhe de jure se Trepça është e shkëputur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Pra, bazuar në ligj, do të duhej ta kishit bordin e dhe menaxhmentin e ri, statusin e vet si ndërmarrje publike. Me ligjin e ri, asnjë nga këto të përmendura nuk do të mund të zgjidheshin, përderisa nuk është i zgjedhur bordi, që i bie se asnjë nga këto që i përmenda nuk janë zbatuar. Mbi cilën bazë ligjore, aktualisht po menaxhohet Trepça, fondet e saj, asetet e saj, me ligjin e ri apo atë të vjetër? A mund të themi se është ndërmarrje publike apo është ndërmarrje nën menaxhim të AKP-së? A mund të na sqaroni se ku është vendimmarrja dhe llogaridhënia e Trepçës sot? Nga vizitat e juaja dhe të kryeministrit, kemi parë zotime rreth Trepçës, keni thënë se ky do të jetë vit i Trepçës, dua ta di, a ka filluar të jetë vërtet viti i Trepçës? Kemi pasur shpallje të konkursit për plotësimin e bordit, por çdo gjë ka mbetur në pikën zero, cilat janë problemet dhe vështirësitë? Besoj që sot, me raportimin tuaj në këtë komision, do të gjejmë zgjidhje bashkërisht.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik – Në momentin që kam marrë detyrën e ministrit, Trepçën e kemi gjetur me status të pazgjidhur, dhe në momentin e parë, kemi filluar procesin e shpalljes për emërimin e Bordit të Trepçës, rreth asaj se a mund ta konsiderojmë si ndërmarrje publike apo nën menaxhim të AKP-së, nuk qëndron as njëra, as tjetra, sepse nuk ka ndonjë status të definuar, por pa marrë parasysh, AKP i ka hequr të gjitha obligimet ndaj Trepçës dhe për disa veprime operative MZHE merret me të, p.sh. autorizimi për eksport të koncentratit apo të xeheve, e bën MZHE. Vendimmarrja, deri më 6.2.2018, ka qenë drejtori i Trepçës, dhe pas kësaj date, janë autorizuar zëvendës drejtori dhe drejtori i Financave, për nënshkrime. Pra, vendimmarrja është transferuar te këta normalisht, duke mos penguar proceset ditore të Trepçës. Pasi nuk është ndërmarrje me status të caktuar edhe llogaridhënia është më problematike. Ne kemi Komitetin Ndërministror për ndërmarrje publike dhe njësinë monitoruese për ndërmarrje publike, në të cilat të gjitha ndërmarrjet publike raportojnë për punën e tyre. Në rastin konkret, Trepça nuk ka një bord dhe nuk ka një statut të definuar, por nuk ka gjithashtu edhe formë të monitorimit apo llogaridhënies, pa marrë parasysh asaj që në

momentin që kam ardhur kam shprehur interesimin tim. Bordin, sipas proceduarave, presim ta kemi funksional shpejt. Tani është koha e intervistave më 25 mars dhe në fillim të muajit prill presim ta kemi të kompletuar Bordin e Trepçës. Pra, kemi 9 (nëntë) anëtarë të Bordit, 2 (dy) prej tyre vijnë nga përfaqësuesit e punëtorëve, pasi që janë 20% aksionar dhe 7 (shtatë) vijnë nga përfaqësues të Qeverisë. Sa i përket pjesës së operimit, Trepça ka pasur të hyra stabile në kuptimin e qarkullimit vjetor, ka pasur një qarkullim rreth 15 milionë euro në vit, mirëpo problemi ka qenë që ka pasur rënie të prodhimit, të përpunimit të xeheve, edhe pse kemi qenë në një kohe kur xehet, siç janë zinku dhe plumbi, kanë pasur një rritje të çmimit mbi 40% brenda dy viteve apo brenda 3-4 viteve, ka pasur një trefishim të çmimeve. Qeveria e Kosovës e ka subvencionuar në vazhdimësi me 3.2 milionë euro në vit për investime kapitale. Vitin e fundit, Trepça e ka përmbyllur me rreth plus 600.000 euro, ku të gjitha vitet deri më tani kanë qenë me minus 2 apo 3 milionë euro. Nëntë muajt e parë të vitit 2017, është i ngjashëm me atë të vitit 2016. Numri i punëtorëve ka qenë në zvogëlim e sipër që nga viti 2013, kur ka filluar me diku 1560 punëtorë dhe sot i ka diku rreth 1360 punëtorë. Kjo rënie e punëtorëve është kryesisht për shkak të pensionimit të stafit të punëtorëve. Komisioni Ndërmintor, në mbledhjen fundit që kemi pasur për ndërmarrjet publike, kemi marrë vendim bashkërisht, që të bëjmë kërkesën te auditori i përgjithshëm apo një auditor i jashtëm, që ta bëjë auditimin e Trepçës.

Memli Krasniqi– 6 muaj janë shumë, që të kalojnë në udhëheqje të ministrisë dhe ende të mos ndërmerret asnjë hap konkret në funksionalizimin, qoftë legjislativ, ligjor, funksional për Trepçën. Atëherë, frika ime është se edhe në 6 muajt e ardhshëm nuk do të arrini ta fusni në binar situatën në Trepçë. Nuk do të besoj në fillim të mandatit të kësaj Qeverie që do të kalonin 6 muaj e nuk do të ketë bord aktiv të Trepçës. Pse disa muaj pas përfundimit të konkursit të hapur publik për Bordin e Trepçës, është pezulluar ky proces? Në bazë të informatave që i kemi, jo krejt zyrtare, janë diku 100 kandidatë që kanë shprehur interesim dhe besoj nga 100 të interesuar keni mundur të zgjidhni 9 më të mirët, për t'i dhënë drejtim zhblokimit të situatës në Trepçë. E dyta, ju i deklaruat disa prej problemeve, por unë jam i bindur që në këtë mungesë të qartësisht legal, gjithmonë rrezikohet të bëhen gabime në hapa. Ta zëmë, ju keni marrë vendim që t'i transferoni kompetencat nga drejtori të zëvendës-drejtorit dhe drejtorit të Financave, si ka ardhur deri te ky proces, a është vendim i juaji si ministër apo kush e ka marrë këtë vendim?

Shkumbin Asllani, këshilltar i ministrit – Funksionimi i Trepçës është i rregulluar me akte të brendshme të ndërmarrjes, qasja në llogari i ka kaluar zëvendës-drejtorit, pasi kjo është mënyra e vetme e rregullimit. Komisioni Ndërmintor nuk ka mundur të vendosë për një çështje që nuk është e sanksionuar as me Ligjin për Trepçën, e as me Ligjin për ndërmarrjet publike, për atë arsye ministrat kanë vendosur mos ta shqyrtojnë këtë çështje.

Memli Krasniqi– Ne kemi një situatë të ngjashme edhe në një ndërmarrje tjetër, ku tash po flasim për Trepçën, nëse drejtorin e ka zgjedhur AKP dhe tani kompetencat kanë kaluar nga AKP te Qeveria ose të paktën do ishte dashur të kalonin. A ka arsye ligjore apo edhe politike se pse nuk keni vepruar me procedim për zgjedhjen e Bordit të Trepçës? Një pyetje tjetër, nëse situata që ka ndodhur me drejtorin z. Ahmet Tmava, çfarë veprimesh keni ndërmarr me drejtorin në veri, a keni marrë vendim të njëjtë edhe për drejtorin në veri? Sepse, edhe procedura e zgjedhjes së drejtorit në veri, është e njëjtë me atë të zgjedhjes së drejtorit Tmava. Dhe në fund,

do të ishte shumë me rëndësi, që mos të rrezikohet në asnjë moment, për shkak të rëndësisë jashtëzakonisht të madhe të Trepçës, si ndërmarrje dhe si aset ekonomik nacional, mos të rrëshqitet në rrezikun e spastrimeve, të cilat mund të kenë konotacion politik apo partiak, sepse mendoj që Trepça është mbi partitë politike dhe mbi Qeverinë, përkundër faktit që kanë kaluar 6 muaj dhe ende nuk kemi bordin, si rrugë për zhvillimin e Trepçës. Për numrin e punëtorëve, ju thatë se janë rreth 150 punëtorë më pak, a do të thotë se nuk ka nevojë për ata punëtorë, sepse Trepça mund të funksionojë edhe pa ata 150 punëtorë ose a keni planifikime t'i zëvendësoni ata punëtorë?

Valdrin Lluka– Sa i përket zgjedhjes së bordit, procedurat i kemi filluar me kohë, janë stërzgatur dhe janë pjesë e procedurave që i bën komisioni për vlerësim të kandidateve, pra janë 120 kandidatë. Unë, si ministër, nuk ndërhyj në punën e komisionit. Te pjesa e investimeve, ju e dini se çdo investim që vjen në Trepçë duhet ta ketë edhe miratimin e kuvendit, andaj ne mund të kontaktojmë investitorë potencialë, por jo të vendosim për investime.

Dardan Sejdiu – Më vjen keq që kolegu Memli nuk është këtu dhe i cili foli për 6 muajt e fundit të Trepçës, por e vërteta është se Trepça po tentohet të trajtohet që 18 vite dhe unë dua të shtroj pyetje konkrete, të cilat ndërlidhen me implementimin e Ligjit të Trepçës. Kur është sjellë ky ligj në Kuvendin e Kosovës edhe leximi i parë, edhe i dytë janë bërë brenda 24 orëve. Pyetja e parë lidhet me “Kapitullin II - Organizimi dhe regjistrimi, neni 6, paragrafi i parë, ku thuhet: Struktura organizative, kapitali themeltar, menaxhimi dhe çështjet tjera organizative specifike të Trepça Sh.A, përcaktohen në statutin e shoqërisë aksionare sipas ligjit”. Pyetja ime është, cilit ligj, atij për ndërmarrjet publike apo atij për shoqëritë tregtare? Pastaj, “Kapitulli V – mundësitë e pjesëmarrjes së sektorit privat”, a mund të më thoni se cili ligj tjetër në Republikën e Kosovës e definojnë apo merret me mundësinë e pjesëmarrjes së sektorit privat në të cilën Qeveria është aksionare, pra në cilin ligj tjetër shkruan se kapitali privat mund të hyjë në ndërmarrje dhe a mund të ma tregoni qëllimin e futjes së këtyre neneve, të cilat rregullojnë ndërmarrjet? Pjesëmarrja e punëtorëve, në ligj është e caktuar se 20% e Trepçës është në pronësi të punëtorëve, a mund të më thoni se si do t'i paraqesin këto aksione, çfarë do të marrin punëtorët apo përsëri po merremi me një ligj, i cili na krijon probleme, për të zhvilluar Trepçën. Dhe në fund, kur ju thatë se do të bëni auditim të Trepçës, çka do të auditoni, performancën financiare apo të futeni në analizë të saktë, se çfarë potenciali minerar ka Trepça?

Valdrin Lluka– Sa i përket pyetjes së parë, dy ligje merren për bazë, Ligji për ndërmarrjet publike dhe Ligji për shoqëritë tregtare. Në pjesën ku kanë konflikte, mbizotëron Ligji për shoqëritë tregtare. Sa i përket auditimit, po flasim për auditim financiar, kurse sa i përket pasurisë së Trepçës, në momentin kur funksionalizohet bordi dhe të rekrutohet menaxhmenti, detyra e tyre e parë do të jetë verifikimi i rezervave të Trepçës.

Dardan Sejdiu– Një përgjigje nuk e kam marrë ende, e cila ka të bëjë me pjesën e investimeve private në Trepçë. Pyetja ishte, a ka ndonjë ligj tjetër që ka këso lloj nenesh, dhe e dyta, a mendoni se ky ligj rregullon edhe çështjen e investimeve private?

Shkumbin Asllani– Ju e dini që çështjet e investimeve në ndërmarrjet publike rregullohen me

Ligjin për partneritet publiko-privat, Komisioni Ndërmatoror është ai që mund ta klasifikojë si të tillë dhe mandej është ligji që e rregullon.

Kryetarja– Mendoj se historiku i Trepçës do na hynte në punë, neve, për t’i përmirësuar gabimet që nuk kanë mundur të rregullohen. Trepça ka një historik jo vetëm 6 mujor, jo vetëm 18 vjeçar, por një historik shumë më të hershëm dhe ne nuk mund të kthehemi mbrapa në histori dhe të humbim kohë në funksionalizim të Trepçës. Unë vetëm dua t’ua përkujtoj se Trepça, deri më 31.10.2016 ka qenë nën menaxhimin e AKP-së, e cila e ka pamundësuar zhvillimin e Trepçës, në një formë. Po ashtu, dua të rikujtoj se ka pasur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, që e kanë penguar dhe nuk e kanë votuar këtë ligj, ka pasur edhe të atillë që e kanë dërguar edhe në Gjykatë Kushtetuese. Ky ligj, ne e dimë se nuk është më i miri i mundshëm, mirëpo nuk është pengesë që t’i ndërmarrim disa hapa në zbatim të tij. Së pari, të formojmë bordin dhe të shohim ku qëndrojnë pengesat në zbatim. Në vitin 2007, jemi bërë bashkë të gjithë, pozitë dhe opozitë dhe e kemi shpëtuar Trepçën nga likuidimi në atë kohë. Tani jemi në një situatë krejt tjetër edhe politike dhe është e rrugës që të fillojmë zbatimin e tij dhe pastaj do të shohim ku qëndrojnë pengesat në zbatim.

Billall Sherifi –Nuk mendoj se është çështje e mungesës së aftësisë për ta menaxhuar Trepçën, çështje e aftësisë për ta zbatuar ligjin, por është çështje politike, për arsye që të gjithë i dimë. Pra, është çështje kryekëput politike në mes të aksionarëve formalë të ligjshëm dhe në mes të atyre që kanë një ndikim jashtëzakonisht të madh në rrugëtimin e Trepçës. Mua më intereson që ta di se pas të gjithë këtyre hapave që janë ndërmarrë, a ka shkelje ligjore? Sepse u krijua përshtypja se këto vendime që janë marrë, janë në kundërshtim me ligjin, dhe a keni ndonjë informate së paku nga kryetari i juaj, sidomos me këta aksionarët joformalë, jo të ligjshëm, a ka ndonjë marrëveshje për të dalë nga ky qorrsoak dhe për të ecur përpara? Dhe te Telekom, a është situata e ngjashme me Telekomin apo kemi dy situata të ndryshme, sepse njërit i është vazhduar kontrata për 3 muaj, kurse tjetrit nuk i është vazhduar. Pra, nëse është e ngjashme, atëherë pse ka ndodhur ky veprim i ndryshëm?

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik – Sa i përket pyetjes se a ka shkelje ligjore, po të kishte shkelje ligjore, nuk do të vazhdohej tutje, po absolutisht kemi qenë tepër të kujdesshëm dhe çdo veprim ka qenë i ligjshëm, kurse sa i përket marrëveshjes me pjesën e minoriteteve, është diskutim i nivelit me të lartë. Ne, si MZHE, merremi proceduralisht që të shkojë çdo gjë në rregull. Pyetja e fundit është shtyrja e afatit të drejtorit të Telekomit, karshi Trepçës. Telekom është ndërmarrje publike, dhe si e tillë, ne e kemi Komitetin Ndërmatoror, i cili i mbikëqyrë ndërmarrjet publike, përmes njësisë për monitorim. Trepça nuk është në të njëjtin status, sepse nuk është ndërmarrje publike dhe nuk jemi pronar, prandaj kemi qenë të rezervuar në këtë pikë.

Kryetarja– Sa i përket tërheqjes së paraleleve në mes të drejtorit të Telekomit dhe atij të Trepçës, dihet situata në Telekom, e kanë Komisionin Ndërmatoror, që është mbikëqyrës, kurse tek Trepça ka kompleksitet të situatës, sepse me sa di unë, nuk ka ndonjë akt normativ të brendshëm që sqaron situatën dhe behët bartja e kompetencave, në rast të dorëheqjes apo skadimit të mandatit të drejtorit. Problemi për mua qëndron në atë se nuk ka filluar të zbatohet ligji.

Hykmete Bajrami– Ju thatë se për shkak të statusit të definuar të Trepçës dhe për shkak të mos-funksionalizimit të ligjit e keni parë që nuk keni kompetencë si Njësi për monitorim të politikave dhe si Komision Ndërmintor, që t’i vazhdoni mandat dikujt, por duke u nisur qoftë edhe nga termat e referencës së zëvendës-drejtorit, ku ai automatikisht n; mungesë të drejtorit merr kompetencat, m; duket si zgjidhje më valide. Për mua mbetet shqetësim moszgjidhja e bordit dhe menaxhmentit, sepse kur kemi parasysh gjithë këtë situatë të padefinuar dhe mungesën e një organizmi monitorues për Trepçën, për një kohë të gjatë, lë shumë për të dëshiruar. Para ndryshimit të statusit të ndërmarrjes Trepça, a keni planifikuar që të keni komisione apo procese monitoruese gjatë kalimit? Ne e kuptojmë që janë të njëjtit punëtorë dhe të njëjtat asetë. Megjithatë, konsideroj se me rastin e ndryshimit të statusit të Trepçës në ndërmarrje, sipas ligjit në fuqi, ajo më së shumti i ngjan ndërmarrjes publike, d.m.th. të ketë një regjistër për të gjitha asetet dhe këtu të përfshihen edhe borxhet eventuale. Kur jemi te drejtorët e ndërmarrjeve publike, me intereson ta di, a ka monitorim të performancës së tyre, sepse kemi dëgjuar raste kur një drejtor i një ndërmarrjeje publike, me performacë shumë të dobët, kryen mandatin e tij në një ndërmarrje publike dhe i njëjti emërohet kryeshef në një ndërmarrje tjetër dhe kjo nuk ishte dashur të ndodhë.

Valdrin Lluka– Sa i përket pjesës së inventarizimit të Trepçës, normalisht, në momentin që bëhet pranim-dorëzimi duhet ta kemi një vlerësim të asetëve dhe kjo duhet të bëhet nga një kompani e jashtme. Sa i përket vlerësimit të bordit dhe menaxhmentit të ndërmarrjeve publike, hera e fundit që është bërë, është para 3 viteve, dhe tani në momentin që kam ardhur, kam shikuar mundësitë për të bërë një vlerësim, andaj, si rezultat, kam kontaktuar me disa donatorë, nga të cilët kam marrë përkrahje, ku do të bëhet një auditim tërësisht i jashtëm dhe profesional, prandaj ju them se një gjë e tillë është në proces. Nuk mund t’ju them ndonjë datë se kur do të ndodhë. Po ashtu, kam biseduar me auditorin e përgjithshëm, i cili deri më tani ka bërë auditimin për 4 ndërmarrje publike dhe nga viti i ardhshëm do të vazhdojë me auditim të 9 ndërmarrjeve publike.

Dardan Sejdiu– Po e ripërsëris një pyetje që nuk mora përgjigje. A është bërë ndonjë formulë për llogaritjen e 20% të pasurisë që u takon punëtorëve, pasi që nuk e dimë se cila është pasuria reale e Trepçës dhe a konsideroni që ka filluar zbatimin e Ligjit për Trepçën, me hapjen e konkursit për Bordin e Drejtorëve?

Valdrin Lluka– Sa i përket 20%, normalisht kur të bëhet vlerësimi i asetëve, do të bëhet e qartë edhe kjo vlerë, sepse në këtë situatë nuk e dimë saktë vlerën e asetëve. Sa i përket zbatimit të Ligjit për Trepçën, ne besojmë që ka filluar zbatimin e ligjit.

b) Ndërmarrja Publike Posta e Kosovës SH.A.

Kryetarja ia dha fjalën ministrit, që të raportojë lidhur me gjendjen në Postën e Kosovës.

Valdrin Lluka– Posta e Kosovës është një ndër kompanitë publike që operon me humbje, me një qarkullim vjetor 10 deri në 11 milionë euro. Në vitin 2016, ka qenë rreth 12 milionë, qarkullimi vjetor, kurse për vitin 2017, raporti ende nuk është i audituar. Sipas raportit, në vitin 2016, ka pasur humbje rreth 1.5 milion euro, kurse në vitin 2017 rreth 1.8 milion euro. Është me rëndësi të kuptohet që rreth 40% e të hyrave të postës janë shpenzime për pagesën e qirave për shfrytëzimin të objekteve. Momentalisht, posta ka rreth 1020 punëtorë, me rrogë mesatare rreth

820 euro, operon me shpenzime kryesore për listën e pagave, vazhdon të ketë sfida, përderisa vazhdon të ketë rekrutim të punëtorëve. Në përpjekje për të ndihmuar postën, jemi munduar që të kemi më shumë skema sociale që të shpërndahen përmes postes. Aktualisht, kemi dy skema sociale që shpërndan posta, kurse janë gjithsej rreth 28 skema të ndryshme. Kjo do t'i ndihmonte postës që të rrisë inkasimin dhe të mbulojë një pjesë të madhe të shpenzimeve. Posta ka kërkuar ndryshimin e formës së subvencionimit nga MZHE, e cila nuk ka shkuar sipas kritereve që parashihen me ligj dhe si rezultat, nuk është subvencionuar posta në vitin e fundit.

Kryetarja– Do të ishte lehtësi shpërndarja e skemave sociale përmes postës. Lidhur me këtë, kam pasur rastin nga mediat të shoh një kontratë në mes të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe postes për shpërndarjen e këtyre skemave. Pra, kjo do të ishte në të mirë të performancës së postës, por edhe për vetë përfituesit dhe do dëshiroj të kuptoj si një hap tuajin që do ta ndërmerri në këtë drejtim.

Hykmete Bajrami– Besoj se një nga arsytet e krijimit të humbjeve të ndërmarrjeve publike është pikërisht mungesa e marrjes së përgjegjësisë. Nëse një gjë e tillë nuk është e rregulluar me Ligjin për ndërmarrjet publike, kërkoj nga ju që ta plotësojmë, ta ndryshojmë ligjin dhe pas çdo viti të bëhet vlerësimi i bordit dhe menaxhmentit, sepse kjo do ta rrisë edhe performancën e tyre. Ajo që vërehet prej raporteve të performancës së postës, është ajo që posta në kohën kur gjeneron humbje, ata e ngrenë numrin e punëtorëve. Si do të veproni ju, përmes Komitetit Ndërministror, që të ndaloni praktika të tilla? Sa i përket shpërndarjes së skemave sociale, përmes postës, kam frikë që do ta mbajmë gjallë një ndërmarrje e cila ka afarizëm negativ, nuk jam kundër që këto skema të shpërndahen përmes postës dhe jo përmes bankave komerciale, mirëpo, fillimisht, duhet të kemi një arsye ekonomike.

Kryetarja– Para 3 ose 4 viteve, kur posta ka lidhur një kontratë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale, që ka qenë diskutim edhe i këtij komisioni në Kuvend, është se ndërhyrjet politike nuk e kanë zbatuar marrëveshjen. Sa i përket çmimit, përderisa ministria, për shpërndarje të pensioneve nëpërmjet bankave komerciale do të paguante 1.5 euro, kurse me marrëveshje ka qenë që nëse shkojnë pensionet përmes postës, çmimi do të jetë 0.50 cent dhe i bie që ka pasur llogari ekonomike për të dy palët, edhe për ministrinë, por edhe për përfituesit, sepse posta me marrëveshje do të dërgonte pensionet në adresa të qytetarëve përfitues.

Valdrin Lluka– Sa i përket dhënies së përgjegjësisë, Ligji për ndërmarrjet publike është duke u ndryshuar dhe besoj se në muajin prill do ta kemi në Kuvend. Ligji parasheh rritjen e dhënies së përgjegjësisë dhe llogaridhënies, kurse sa i përket benefiteve për anëtarët e bordeve, ne si ministri kemi nxjerrë një vendim, me cilin ndalojmë dhënien e bonuseve dhe kemi ndaluar shpenzimet e paarsyeshme. Kurse, sa i përket shpenzimeve operative, është shumë shqetësuese për postën, sepse rreth 90% e shpenzimeve operative janë paga dhe normalisht një ngarkesë e tillë për secilën ndërmarrje është e tepërt. Sa i përket shpërndarjes, përmes skemave sociale, është e leverdishme dhe e përshtatshme, për faktin se posta ka pika në gjithë territorin e Kosovës, më shumë se secila bankë komerciale dhe një gjë e tillë është duke u shikuar si mundësi për t'u funksionalizuar, në kuptimin që të gjitha skemat të shpërndahen përmes postës.

Dardan Sejdiu– Nga raporti i vitit 2016, shoh se kemi të hyra rreth 11 milionë, kurse shpenzime për paga janë 9.2 milionë. A mund të më shpjegoni se me ligjin e ri për ndërmarrjet

publike, çfarë lloj kompetencash i lejohen ministrisë apo Njësisë monitoruese në këso lloje situatash? Kemi deklarin e drejtorit të postës, i cili thotë se për rreth 1020 punëtorë për muajin që vjen nuk do të kemi paga. Çfarë veprimesh do të ndërmerri në këtë situatë? Në Komunën e Prishtinës, tash e 4 vite, bëhet dërgesa e çdo letre me postë, madje edhe faturat e ujit tash kanë filluar të dërgohen me postë dhe kemi heq komplet sektorin privat dhe ka qenë procedurë shumë e thjeshtë. A ekziston edhe diçka e tillë edhe në Ligjin për ndërmarrjet publike, ku me ndonjë dispozitë të caktohet që blerësi i shërbimeve publike, kur është Qeveria ose ndonjë institucion shtetëror, të marrë shërbim nga ndërmarrjet publike? Në anën tjetër, kam një pyetje sa i përket raporteve që ju dërgojnë juve ndërmarrjet publike. Ato, gjithsesi, ju dërgojnë edhe planin e biznesit, raporti mbi planin e biznesit për postën për vitin 2017 dhe realizimi i planit, a është i përafërt, a është planifikimi i përafërm me realizim apo jo?

Valdrin Lluka– Sa i përket Ligjit për ndërmarrjet publike, ideja është që të krijohet një agjenci që do të merret enkas me ndërmarrjet publike. Sa i përket pjesës së përdorimit të shërbimit që ofrojnë ndërmarrjet publike, pa proces të tenderimit, nuk mund të ndodhë, sepse ne duhet të ofrojmë mundësi të barabarta, si për ndërmarrje publike, ashtu edhe për ato private. Mandej është edhe fakti se ne e subvencionojmë ndërmarrje publike, dhe në anën tjetër, të përdorim shërbimin e tyre. Me ligjin e ri nuk parashihet të ketë favorizim në këtë aspekt.

Shahe Kukaj – Krasniqi, zyrtare e Ministrisë – Sa i përket marrëveshjes me ndërmarrjet tjera publike, ju njoftoj se posta, së fundmi, ka arritur marrëveshje me kompaninë rajonale të ujësjellësit “Mitrovica”, për shpërndarjen e faturave dhe jemi në përpjekje për të arritur kontrata të tjera. Sa i përket realizimit të planit të biznesit, duke krahasuar ato me raportet vjetore, mund të themi se ndërmarrjet publike bëjnë planet e biznesit, duke punuar sipas asaj që dëshirojnë.

Kryetarja– Ne, si shtet, jemi përcaktuar për ekonomin e lirë të tregut dhe ta zhvillojmë konkurrencën. Po ashtu, ne nuk jemi ata që menaxhmenteve, me ligj, t’ua rregullojmë çdo gjë, mirëpo ata duhet të hulumtojnë dhe të gjejnë forma të bashkëpunimit dhe të krijojnë marrëveshje.

c) Ndërmarrja Publike Telekomit i Kosovës SH.A.

Valdrin Lluka– Edhe Telekomit përballet me sfida relativisht të mëdha. Që nga viti 2013 ka pasur rënie të shitjes së shërbimeve, ta marrim shembull në vitin 2013 ka pasur rreth 130 milionë euro qarkullim apo rreth 37 milionë euro fitim, kurse në vitin 2017 ka pasur rreth 71 milionë euro shitje, kurse ka raportuar rreth 15 milionë euro humbje. Pra, ka pasur rënie të vazhdueshme që nga viti 2013, ku shitja ka rënë në vazhdimësi. Telekomit ka të raportuar 2291 punëtorë, me një pagë mesatare prej 980 eurosh, që i bie shpenzime të pagave rreth 27 milionë euro dhe normalisht kjo shkakton probleme të vazhdueshme. Sipas raportit të auditorit për vitin 2016, parashihet një humbje jashtëzakonisht e madhe, rreth 51 milionë euro. Kjo duhet të shihet me rezervë, sepse 28 milionë euro, nga këto 51 milionë euro, janë të ndara për rastin e arbitrazhit, andaj humbja reale do të jetë 23 milionë euro. Zhvlerësimi dhe amortizimi kap shumë prej rreth 23 milionë eurosh, shpenzimet tjera që janë operative janë rreth 37 milionë euro, qiratë janë rreth 10 milionë euro. Humbja e vitit 2017 ende nuk është audituar, por është rreth 15 milionë euro.

Hykmete Bajrami– Sa ka qenë numri i punëtorëve në vitin 2013?

Valdrin Lluka – Në vitin 2013 numri i punëtorëve ka qenë 2370.

Bilall Sherifi– Kur një ndërmarrje operon me humbje, cilët janë hapat e parë që ndërmerrni? Kur do të filloni me masat e ndërmarrja, kur një kompani më shumë harxhon sesa fiton? Pra, nuk ka kuptim që një ndërmarrje që operon me humbje, të ketë rrogë mesatare aq të lartë.

Valdrin Lluka– Normalisht, duhet të shikojmë se si ka ardhur deri te humbja dhe ndërveprimet e para është vendosja e bordit, dhe në momentin që do të kemi bordin, do të ndërmerren masat e strukturimit, sepse është problemi kryesor. Nga ana tjetër, kemi formuar një grup punues, duke filluar procedurat për qeverisje të përbashkët. Ky grup do ta ketë për detyrë identifikimin e masave që duhet të ndërmerren dhe çfarë forme e ristrukturimit duhet ndjekur për ta kthyer në një kompani fitimprurëse.

Hykmete Bajrami– Në fakt, vërejtjet e njëjta që i bëme për postën, vlejné edhe për Telekom, sepse gjendja është thuajse e njëjta. Rekrutimi i punëtorëve mbetet problem dhe nuk është vetëm teknologjia dhe shfrytëzimi i viberit, si arsye për rënie të të hyrave, sepse kemi operatorin privat që me rreth 38% të tregut ka gjeneruar të hyra, përafërsisht sa Telekom, i cili ka rreth 60% të tregut. E vërteta është se Telekom ka ngecur mbrapa në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, mandej është kontrata me Z mobile, që ka ndikuar në rënien drastike të kësaj kompanie, mirëpo besoj që me ardhjen e një bordi dhe menaxhmeti të ri, situata duhet të ndryshohet dhe nga MZHE të kërkohet një strategji për daljen nga kjo situatë.

Valdrin Lluka– Sa i përket numrit të punëtorëve, ka mundësi që ka pasur pensionime dhe për këto janë të dhënat e audituara, ku për vitin 2016, kemi pasur 2279 punëtorë në Telekom, në vitin 2017 janë raportuar 2291 punëtorë. Pajtohem që ka munguar kreativiteti në ofrimin e shërbimeve, mirëpo, realisht Telekom është i stërngarkuar, ku realisht nuk besoj që i duhen mbi 600 ose 700 punëtorë.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të monitorojë punën e ndërmarrjeve publike, ku do të ndikojë në dinamizmin e punës edhe të vetë ministrisë.

5. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Kryetarja njoftoi për një vizitë në KOSST, me iniciativën e KDI-së, ku do të diskutohet lidhur me zbatimin e marrëveshjeve me Serbinë, andaj i ftoi deputetët që të marrin pjesë në këtë takim, për të cilin stafi do t'ju njoftojë për kohën dhe detajet tjera.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA